



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1592/5 prot.

Datë 23.06.2026

V E N D I M

Nr. 850/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.06.2026 u shqyrtua ankesa me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Gajd Company” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-77570-02-26-2026, me objekt: “*Loti I: Blerje goma*”, me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Rugeve dhe Ndrçimit Publik Tirane.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Pergjithshme e Rugeve dhe Ndrçimit Publik Tirane, me adresë: Rruga “5 Maji”, Tiranë

Ankimues: Operatori ekonomik “Gajd Company” SHPK me NUIS K79631501Q dhe adresë: Rruga Fushe-Tepelene, Zone Kadastrale Nr.3574, Nr.Pasurie 8/22, Tepelene.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27.02.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-77570-02-26-2026, me objekt: “Loti I: Blerje goma”, me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tirane.

II.2. Në datën 08.05.2026 autoriteti kontraktor ka përfunduar fazën e vlerësimit të ofertave. Ofertuesit janë njoftuar elektronikisht si vijon:

- | | |
|------------------------|------------------------------|
| 1. “GAJD Company” SHPK | 8,975,200lekë, skualifikuar |
| 2. “TYRE MASTER” SHPK | 9,323,600 lekë, kualifikuar |
| 3. “inAuto” SHPK | 9,360,000 lekë, skualifikuar |

Operatori ekonomik “Gajd Company” SHPK është njoftuar për arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

“OE GAJD Company sh.p.k. nuk ploteson piken 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim Prodhuesi / Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi, për mallrat objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, Eëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij..... Pasi OE ka paraqitur nje kontrate shitje me PB TIRE S.R.O. i cili i jep PRO-TIRE SHPK te drejten ekskluzive te distributorit për territorin e Shqiperise dhe PRO-TIRE SHPK i jep GAJD Company shpk autorizimin të tregëtojë mallrat Goma, për të cilat shoqëria jonë është e autorizuar si distributor ekskluziv per brandet/markat e gomave Nexen, Kumho, Doublestar, Comforser, Gripmax, Speedäays, Xingyan, Long March, Mirage, Agate, Aufine, Rotalla, Routeëay, Three-A, Everton dhe SEHA. Por nga verifikimet ne WEB rezulton se PB TIRE S.R.O. eshte distributor dhe jo prodhues i këtyre markave sic janë paraqitur dhe ne katalogë duke e bere te pamundur të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.”

II.3. Në datën 14.05.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit të procedurës së prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 21.05.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik, me nr. A/2026/6697, protokolluar me nr.1592/2026 prot, datë 22.05.2026, i operatorit ekonomik “Gajd Company” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-77570-02-26-2026, me objekt: “Loti I: Blerje goma”, me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugeve dhe Ndriçimit Publik Tirane.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Gajd Company” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“Rrethanat dhe faktet

GAJD Company sh.p.k. (NUIS: K79631501Q), shoqëri aktive prej vitit 2007 me objekt tregëtimin e gomave, paraqiti ofertë për procedurën REF-77570-02-26-2026, Loti I: Blerje Goma , organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë. Për plotësimin e kriterit 2.3.2 të DST, paraqiti: (1) Autorizim distributor datë 09.04.2026 nga PRO-TIRE SHPK (NUIS: L71312509H), i cili autorizon GAJD Company sh.p.k. shprehimisht për tenderin REF-77570-02-26-2026 për 15 markat e gomave (Nexen, Kumho, Doublestar, Comforser, Gripmax, Speedäays, Xingyan, Long March, Mirage, Agate, Aufine, Rotalla, Routeëay, Three-A, Everton dhe SEHA), duke deklaruar se PRO-TIRE SHPK është distributor ekskluziv i këtyre markave në Shqipëri; dhe (2) Kontratën e Shitjes 2024-2025-2026 të lidhur më 15.02.2024 midis PB TIRE S.R.O. (Bratislava, Slovakia) si Shitës/Principal dhe PRO-TIRE SHPK si Blerës/Distributor

Ekskluziv për territorin e Republikës së Shqipërisë, e vlefshme deri më 31.12.2026, e noterizuar dhe e përkthyer zyrtarisht nga noter i licensuar. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave skualifikoi ofertën pa kërkuar asnjë sqarim nga ankimuesi, duke u mbështetur ekskluzivisht në verifikime informale internet, dhe duke konkluduar gabimisht se nuk vërtetohet lidhja e kërkuar sipas DST.

Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

1. SHKELJE E DETYRIMIT PËR SQARIME - Neni 54 i Ligjit Nr.162/2020 Për Prokurimin Publik dhe Kreu VII i VKM Nr.285, datë 19.05.2021, parashikojnë detyrimin eksplisit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të kërkojë sqarime me shkrim nga operatori ekonomik para marrjes së çdo vendimi skualifikimi, kur vëren paqartësi ose mangësi në dokumentacionin e paraqitur. Ankimuesi nuk është kontaktuar dhe nuk i është kërkuar asnjë sqarim. Ky detyrim nuk është fakultativ ? shkelja e tij në vetvete përbën shkak të mjaftueshëm për anulimin e vendimit, pavarësisht vlerësimit substantiv të dokumentacionit. Nëse Komisioni kishte dyshime mbi zinxhirin e autorizimit, rruga e vetme ligjore ishte kërkimi i sqarimeve - jo skualifikimi i menjëhershëm.

1.1. SKUALIFIKIMI ËSHTË I BAZUAR MBI NJE VERIFIKIM INFORMAL NE INTERNET
Vendimi motivohet nga verifikimi ËEB i kryer nga Komisioni. Ky mjet është i papranueshëm ligjërisht: (i) DST nuk e parashikon verifikimin internet si kriter apo metodë vlerësimi; (ii) kriteret e kualifikimit vlerësohen mbi bazën e dokumentacionit zyrtar të paraqitur, sipas rregullave të DST dhe ligjit të prokurimit; (iii) dokumenti i noterizuar dhe i përkthyer zyrtarisht ka fuqi provuese ndaj çdo informacioni informal nga interneti; (iv) faqet ëeb të prodhuesve dhe distributorëve nuk pasqyrojnë gjithmonë rrjetin e plotë aktual të distribucimit, veçanërisht për marrëveshje ndërkombëtare. Konkluzionet e Komisionit bazuar mbi verifikimin ËEB janë ligjërisht të pabazuara dhe nuk mund të shërbejnë si arsye e mjaftueshme skualifikimi.

3 KËRKESË PËR TRAJTIM TË BARABARTË ? Neni 3 i Ligjit Nr.162/2020 Ankimuesi kërkon shqyrtim nëse ofertues të tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë janë kualifikuar duke paraqitur autorizime me zinxhir të ngjashëm distribucioni pa pasur autorizim direkt nga fabrika prodhuese. Nëse KVO ka pranuar dokumentacion të ngjashëm nga ofertues të tjerë dhe ka zbatuar kritere strikte vetëm ndaj GAJD Company sh.p.k., kjo përbën shkelje të rëndë të parimit të barazisë dhe transparencës, të garantuar nga Neni 3 i Ligjit Nr.162/2020.”

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1592/1 Prot., datë 25.05.2026.

II.6. Në datën 05.06.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr.1592/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr.575/16 prot., datë 03.06.2026 me objekt: “Dërgim vendimi”, bashkëngjitur Vendimi i KSHA-së nr.575/15 prot., datë 02.06.2026 lidhur me trajtimin

e ankesës së operatorit ekonomik “Gajd Company” SHPK. Referuar këtij vendimi rezulton se KSHA-ja ka refuzuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues.

II.7.Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, “*Kapaciteti teknik*”, pika 2.3.2, 2.3.3 dhe 2.3.7 e dokumenteve të tenderit të publikuara në SPE, rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor është *parashikuar, si më poshtë vijon:*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim Prodhuesi / Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi, për mallrat objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, Ëëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.3 Operatori ekonomik të paraqesë katalogë / broshurë / skedë teknike për artikujt objekt prokurimi ku të përfshihen emërtimet dhe specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / broshurë / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me artikujt objekt prokurimi.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike për të gjitha gomat, në formë tabele, ku të plotësohet:

Emri i kompanisë prodhuese, Emërtimi i katalogut të artikullit/produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Emërtimi i artikullit (kodi) nxjerrë nga manuali i prodhuesit, linku i produktit në Ëëb-in e prodhuesit si dhe certifikimet përkatëse për secilin produkt.

III.1.2. Në shtojcën 6, “Formulari i specifikimeve teknike”, është *parashikuar:*

SHTOJCA 6

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

GOMA

Nr.	Lloji i mjetit	Lloji i gomës	Njësia
1	Bobcat	10 R16.5	Copë
2	Eskavator Benati	10 R20	Copë
3	Eskavator Terex	10 R20	Copë
4	Fadrim mini/fad Venier	10/75 R 15.3	Copë
5	Giotti Victoria Kullë	155/R13 C	Copë
6	Fiat Iveco	11/R22.5	Copë
7	Fiat Iveco	10 R22.5	Copë
8	Benz 1625	12 R22.5	Copë
9	Fadrom Cat Katerpillar	340/80R18	Copë
10	Iveco Fiat 3 AKS	13 R/22.5	Copë
11	Astra 4 AKS	13 R/22.5	Copë
12	Fadrome Hidromek	160/70 R20	Copë
13	Fadrome Katerpillar	440/80R28	Copë
14	Fadrome Hidromek	440/80R28	Copë
15	Fad kineze Z1 50 d	17.5 R 25	Copë
16	FADROME JCB	12.5/80 R18	Copë
17	FADROME TEREX	16.9 R 30	Copë
18	FADROME TEREX	14.5 R 20	Copë
19	Kama	185/ R14 C	Copë
20	KAMIONCIN FOTON	185/R15LT	Copë
21	AUTOKULLE Nissan Cabstar	195/70R15C	Copë
22	AUTOKULL RENAULT MAXITY	195/70R15C	Copë
23	Benz 308D	215/ R14C	Copë
24	Kamioncinë Volksëagen	205/65 R16 C	Copë
25	Vinc Atego	285/70 R19.5	Copë
26	Fiat Ducato	215/70 R15 C	Copë
27	Kamion KULLE Iveco Fiat Daily	225/75 R 16 C	Copë
28	Benz 814	235/75R 17.5C	Copë
29	Kamion Reno Midlum	285/ 70 R 19.5	Copë
30	KARROATREC RENAULT MIDLIUM	315/80 R 22.5	Copë
31	Kopertona Motorri	17-2.75	Copë
32	Kopertona Motorri	17-2.5	Copë
33	Komerdare Motorri	17-2.75	Copë
34	Komerdare Motorri	17-2.5	Copë
35	Rimorkaitor DEANGELIS	205/65R17,5	Copë
36	TERHEQES IVECO MAGIRUS	315/80R 22	Copë
37	Mitsubishi	205/80R16	Copë
38	Autovinc Iveco	225/65R16C	Copë

39	Renault Maskot	195/75R17.5	Copë
40	Kamion Benz 1622	12 R 22.5	Copë
41	Autokulle Fiat Iveco	195/75R16C	Copë
42	kamion vinc Man	295/80R22.5	Copë
43	kamioncin VETSHKARKUESE BENZ 413	195/70 R 15 C	Copë
44	KAMION VETSHKARKUESE Iveco	195/75 R 16 C	Copë
45	Volksëagen Cady	205/55 R 16 V	Copë
46	KAMIONCIN FIAT IVECO	195/75 R 16 C	Copë
47	KAMIONCIN FORD	195/75 R 16 C	Copë
48	FURGON SINJALISTIK FIAT DUCAT	205/70 R 15 C	Copë
49	Kamion me vinc	195/75 R 16 C	Copë
50	Kamion veteshkarkues MANN	245/70R 17.5	Copë
51	Fadrome Hidromek e vogel	10/16.5 10PR	Copë
52	Freze Asfalti	12-16.5	Copë
53	Fadrome Hidrromek	400/70R20	Copë
54	Kamion Boreastrues Mercedes Benz	315/80R22.5	cope

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.4. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, pika 1 dhe 4, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë

profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.
2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.
3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.1.5. Në nenin 40 pika 1, 2 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrit të mallrave. 2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPPsë, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët

ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.7. Lidhur me arsyet e skualifikimit të ankimuesit, nga ana e këtij të fundit pretendohet se:

“1. SHKELJE E DETYRIMIT PËR SQARIME - Neni 54 i Ligjit Nr.162/2020 Për Prokurimin Publik dhe Kreu VII i VKM Nr.285, datë 19.05.2021, parashikojnë detyrimin eksplisit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të kërkojë sqarime me shkrim nga operatori ekonomik para marrjes së çdo vendimi skualifikimi, kur vëren paqartësi ose mangësi në dokumentacionin e paraqitur. Ankimesi nuk është kontaktuar dhe nuk i është kërkuar asnjë sqarim. Ky detyrim nuk është fakultativ ? shkelja e tij në vetvete përbën shkak të mjaftueshëm për anulimin e vendimit, pavarësisht vlerësimit substantiv të dokumentacionit. Nëse Komisioni kishte dyshime mbi zinxhirin e autorizimit, rruga e vetme ligjore ishte kërkimi i sqarimeve - jo skualifikimi i menjëhershëm.

1.1. SKUALIFIKIMI ËSHTË I BAZUAR MBI NJE VERIFIKIM INFORMAL NE INTERNET
Vendimi motivohet nga verifikimi ËEB i kryer nga Komisioni. Ky mjet është i papranueshëm ligjërisht: (i) DST nuk e parashikon verifikimin internet si kriter apo metodë vlerësimi; (ii) kriteret e kualifikimit vlerësohen mbi bazën e dokumentacionit zyrtar të paraqitur, sipas rregullave të DST dhe ligjit të prokurimit; (iii) dokumenti i noterizuar dhe i përkthyer zyrtarisht ka fuqi provuese ndaj çdo informacioni informal nga interneti; (iv) faqet ëeb të prodhuesve dhe distributorëve nuk pasqyrojnë gjithmonë rrjetin e plotë aktual të distribucimit, veçanërisht për marrëveshje ndërkombëtare. Konkluzionet e Komisionit bazuar mbi verifikimin ËEB janë ligjërisht të pabazuara dhe nuk mund të shërbejnë si arsye e mjaftueshme skualifikimi.

3 KËRKESË PËR TRAJTIM TË BARABARTË ? Neni 3 i Ligjit Nr.162/2020 Ankimuesi kërkon shqyrtim nëse ofertentë të tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë janë kualifikuar duke paraqitur autorizime me zinxhir të ngjashëm distribucioni pa pasur autorizim direkt nga fabrika prodhuese. Nëse KVO ka pranuar dokumentacion të ngjashëm nga ofertues të tjerë dhe ka zbatuar kritere strikte vetëm ndaj GAJD Company sh.p.k., kjo përbën shkelje të rëndë të parimit të barazisë dhe transparencës, të garantuar nga Neni 3 i Ligjit Nr.162/2020.”

III.1.8. Në përgjigjen e dhënë ankesës së paraqitur, KSHA argumenton si vijon: “Në shqyrtim të pretendimeve të operatorit ekonomik « Gajd Company » SHPK, KSHA vlerëson se këto pretendime nuk qëndrojnë si në aspektin faktik ashtu edhe në atë ligjor.

Së pari, në lidhje me pretendimin se KVO ka patur detyrimin të kërkojë sqarime para marrjes së vendimit për skualifikim, KSHA vlerëson se procedura e sqarimeve nuk mund të përdoret për të plotësuar, korrigjuar apo zëvendësuar dokumentacionin që operatori ekonomik ka pasur detyrimin ta paraqesë në momentin e dorëzimit të ofertës. Qëllimi i sqarimeve është vetëm qartësimi i dokumenteve të paraqitura dhe jo krijimi i provave të reja apo plotësimi i mangësive thelbësore të ofertës. Për rrjedhojë, në rastin kur dokumentacioni i paraqitur nuk arrin të provojë në mënyrë të qartë dhe të pakundërshtueshme përmbushjen e një kriteri kualifikues, autoriteti kontraktor nuk ka detyrimin të kërkojë sqarime, por ka të drejtën dhe detyrimin ligjor të vlerësojë ofertën bazuar vetëm në dokumentacionin e depozituar brenda afatit të ofertimit.

Së dyti, lidhur me pretendimin se operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion të mjaftueshëm për të provuar lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit të autorizuar, KSHA konstaton se kriteri i përcaktuar në dokumentat e tenderit kërkon paraqitjen e dokumentacionit që provon në mënyrë të qartë dhe të verifikueshme autorizimin për furnizimin e mallrave objekt prokurimi. Barra e provës për përmbushjen e këtij kriteri bie tërësisht mbi operatorin ekonomik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur një autorizim të lëshuar nga një subjekt i tretë dhe jo nga prodhuesi i mallrave. Në këto kushte, autoriteti kontraktor ka të drejtë të verifikojë vlefshmërinë, autenticitetin dhe shtrirjen e autorizimit të paraqitur, me qëllim garantimin e furnizimit të mallrave nga burime të ligjshme dhe të autorizuar. Vetë ekzistenca e një kontrate ndërmjet PB Tire SRO dhe Pro -Tire SHPK nuk mjafton për të provuar automatikisht se operatori ekonomik « Gajd Company » SHPK gëzon statusin e distributorit të autorizuar për markat objekt prokurimi, nëse nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezulton qartë e drejta e transferimit të autorizimit apo marrëdhënia juridike që legjitimon një autorizim të tillë.

Së treti, në lidhje me pretendimin se autoriteti kontraktor është mbështetur në verifikime në internet, KSHA vlerëson se autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikime të cdo informacioni të paraqitur nga operatorët ekonomikë, me qëllim konstatimin e vërtetësisë së dokumentacionit dhe mbrojtjen e interesit publik. Verifikimi i burimeve publike nuk përbën kriter të ri kualifikimi dhe as ndryshim të dokumentave të tenderit, por një mjet verifikimi i përdorur për të kontrolluar informacionin e paraqitur në ofertë. Për më tepër, fakti që nga burime publike

nuk rezulton autorizimi i pretenduar nga operatori ekonomik përforcon dyshimet mbi plotësimin e kriterit dhe nuk mund të konsiderohet s veprim në kundërshtim me ligjin.

Së fundi, në lidhje me pretendimin për cmimin e parimit të trajtimit të barabartë, KSHA vlerëson se ankimuesi nuk kaparaqitur asnjë provë konkrete që të vërtetojë se operatorët e tjerë ekonomikë janë kualifikuar në të njëjtat kushte faktike dhe juridike. Pretendimet hipotetike ose të pambështetura me prova nuk mund të shërbejnë si bazë për konstatimin e shkeljes së parimit të barazisë në procedurat e prokurimit publik. Për rrjedhojë ky pretendim mbetet në nivel deklarativ dhe nuk provohet nga asnjë element i dosjes administrative.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se operatori ekonomik « Gajd Company » SHPK nuk ka arritur të provojë se përmbush në mënyrë të plotë kriterin e kërkuar në dokumentat e tenderit lidhur me autorizimin dhe zinxhirin e furnizimit, ndërsa pretendimet e ngritura në ankesë rezultojnë të pabazuara në ligj dhe në prova. Për rrjedhojë, vendimi i KVO-së për skualifikimin e ofertës konsiderohet i ligjshëm dhe në përputhje me kërkesat e dokumentave të tenderit dhe legjislacionit në fuqi për prokurimin publik. Për këtë arsye, pretendimi lidhur me opertaorin ekonomik « Gajd Company » SHPK nuk qëndron”.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi ofertën e paraqitur në SPE nga shoqëria ankimuese, ku rezulton se për plotësimin e kërkesës së parashikuar në pikën 2.3.2, 2.3.3 dhe 2.3.7 të dokumentave të tenderit, objekt ankimimi si më sipër cituar, është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

- Goma _ DPN2 _ Katalog
- Oferta teknike, ku deklarohe si vijon:

OFERTA TEKNIKE								
GAJD COMPANY sh.p.k								
DREJTUAR: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRICIMIT PUBLIK								
OBJEKTI: LOTI 1 - "BLERJE GOMA", ME NR. REF. 77570-02-26-2026								
Nr.	Lloji i mjetit	Lloji i gomës	Marka	Katalog / Faqe Katalogu	Kodi i Gome	Vendi Origjines	Website Link	Certifikim
1	Bobcat	10 R16.5			77		https://www.bobcat.com/	ISO 9001:2015
2	Eskavator Benati	10 R20			44		https://www.benati.com/	ISO 9001:2015
3	Eskavator Terex	10 R20					https://www.terex.com/	ISO 9001:2015
4	Fadrim mini/fad Venier	10/75 R 15.3					https://www.fadvenier.com/	ISO 9001:2015
5	Giotti Victoria Kullë	155/R13 C					https://www.giottire.com/	ISO 9001:2015
6	Fiat Iveco	11/R22.5					https://www.fiatveco.com/	ISO 9001:2015
7	Fiat Iveco	10 R22.5					https://www.fiatveco.com/	ISO 9001:2015
8	Benz 1625	12 R22.5					https://www.benz.com/	ISO 9001:2015
9	Fadrom Cat Katerpilar	340/80R18					https://www.fadromcat.com/	ISO 9001:2015
10	Iveco Fiat 3 AKS	13 R/22.5			24		https://www.ivecofiat.com/	ISO 9001:2015
11	Astra 4 AKS	13 R/22.5					https://www.astra.com/	ISO 9001:2015
12	Fadrome Hidromek	160/70 R20					https://www.fadrome.com/	ISO 9001:2015
13	Fadrome Katerpilar	440/80R28					https://www.fadromek.com/	ISO 9001:2015
14	Fadrome Hidromek	440/80R28					https://www.fadromek.com/	ISO 9001:2015
15	Fad kineze Z1 50 d	17.5 R 25					https://www.fadchina.com/	ISO 9001:2015
16	FADROME JCB	12.5/80 R18					https://www.fadrome.com/	ISO 9001:2015
17	FADROME TEREX	16.9 R 30					https://www.fadrome.com/	ISO 9001:2015
18	FADROME TEREX	14.5 R 20					https://www.fadrome.com/	ISO 9001:2015
19	Kama	185/ R14 C					https://www.kama.com/	ISO 9001:2015

					620			
20	KAMIONCIN FOTON	2008-2010	L	Foton T2000			https://www.foton.com/	ISO 9001:2015
21	AUTOKULLE Nissan Cabstar	1998-2010	I	Nissan Cabstar			https://www.nissan.com/	ISO 9001:2015
22	AUTOKULL RENAULT MAXITY	1998-2010	I	Renault Maxity			https://www.renault.com/	ISO 9001:2015
23	Benz 308D	2008-2010	L	Benz 308D			https://www.mercedes-benz.com/	ISO 9001:2015
24	Kamioncin® Volksæagen	2008-2010	L	Volksæagen Crafter			https://www.volkswagen.com/	ISO 9001:2015
25	Vinc Atego	2008-2010	I	Mercedes-Benz Atego			http://www.mercedes-benz.com/	ISO 9001:2015
26	Fiat Ducato	2008-2010	L	Fiat Ducato			https://www.fiat.com/	ISO 9001:2015
27	Kamion KULLE Iveco Fiat Daily	2008-2010	L	Iveco Fiat Daily			https://www.iveco.com/	ISO 9001:2015
28	Benz 814	2008-2010	L	Benz 814			https://www.mercedes-benz.com/	ISO 9001:2015
29	Kamion Reno Midlum	2008-2010	I	Renault Midlum			http://www.renault.com/	ISO 9001:2015
30	ARROATREC RENAULT MIDLIU	2008-2010	I	Renault Midlum			http://www.renault.com/	ISO 9001:2015
31	Kopertona Motorri	2008-2010	L	Kopertona Motorri			https://www.kopertona.com/	ISO 9001:2015
32	Kopertona Motorri	2008-2010	L	Kopertona Motorri			https://www.kopertona.com/	ISO 9001:2015
33	Komerdare Motorri	2008-2010	L	Komerdare Motorri			https://www.komerdare.com/	ISO 9001:2015
34	Komerdare Motorri	2008-2010	L	Komerdare Motorri			https://www.komerdare.com/	ISO 9001:2015
35	Rimorkaitor DEANGELIS	2008-2010	L	Deangelis			https://www.deangelis.com/	ISO 9001:2015

36	TERHEQES IVECO MAGIRUS	2008-2010	L	Iveco Magirus			https://www.iveco.com/	ISO 9001:2015
37	Mitsubishi	2008-2010	L	Mitsubishi			https://en.mitsubishi.com/	ISO 9001:2015
38	Autovinc Iveco	2008-2010	L	Iveco			https://www.iveco.com/	ISO 9001:2015
39	Renault Maskot	2008-2010	L	Renault Maskot			https://www.renault.com/	ISO 9001:2015
40	Kamion Benz 1622	2008-2010	L	Benz 1622			https://www.mercedes-benz.com/	ISO 9001:2015
41	Autokulle Fiat Iveco	2008-2010	L	Fiat Iveco			https://www.fiat.com/	ISO 9001:2015
42	kamion vinc Man	2008-2010	L	Man			https://www.man.com/	ISO 9001:2015
43	ioncin VETSHKARKUES E BENZ	2008-2010	L	Benz			https://www.mercedes-benz.com/	ISO 9001:2015
44	KAMION VETSHKARKUES E Iveco	2008-2010	L	Iveco			https://www.iveco.com/	ISO 9001:2015
45	Volkswagen Cadyy	2008-2010	L	Volkswagen			https://www.volkswagen.com/	ISO 9001:2015
46	KAMIONCIN FIAT IVECO	2008-2010	L	Fiat Iveco			https://www.fiat.com/	ISO 9001:2015
47	KAMIONCIN FORD	2008-2010	L	Ford			https://www.ford.com/	ISO 9001:2015
48	URGON SINJALISTIK FIAT DUCA	2008-2010	L	Fiat Duka			https://www.fiat.com/	ISO 9001:2015
49	Kamion me vinc	2008-2010	L	Man			https://www.man.com/	ISO 9001:2015
50	Kamion veteshkarkues MANN	2008-2010	L	Mann			https://www.mann.com/	ISO 9001:2015
51	Fadrome Hidromek e vogel	2008-2010	L	Fadrome Hidromek e vogel			https://www.fadrome.com/	ISO 9001:2015
52	Freze Asfalti	2008-2010	L	Freze Asfalti			https://www.freze.com/	ISO 9001:2015

53							https://www.terheqes.com/	ISO 9001:2015
54							http://www.terheqes.com/	ISO 9001:2015

- Pro_Tire_per_Gajd_Kontrate, Kontrate shitje për vitet 2024-2025-202, e lidhur ndërmjet shitësit PB Tire SRP, DUNAJSKA 66, 811 08 BRATISLAVA Sllovaki dhe blerësit Pro-Tire SHPK, MAMINAS, DURRËS, TIRANË, SHQIPËRI. Sipas objektit të marrëveshjes, shitësi i jep blerësit të drejtën ekskluzive të distributorit për territorin e mëposhtëm në përputhje me rregullat e përcaktuara më poshtë:

Blerësi mbulon të gjitha markat në bazë të marrëveshjes sonë me furnizuesit direkt:

(përvec të tjerave)

- Doublestar
- Speedäays
- Long March
- Mirage
- Three-A

Në pinë 2 të kontratës “*Statusi ligjor dhe detyrimet e përgjithshme të distributorit*”, është përcaktuar si vijon:

1. *Blerësi duhet të blejë Produktet nga shitësi dhe t'i shesë ato në emrin e vet dhe për llogari të vet.*

2. *Distributori duhet të mbrojë interesat e Shitesit me kujdesin dhe vëmendjen e duhur të një biznesmeni të kujdesshëm. Distributori duhet të ndjeke udhëzimet e shitesit për aq sa këto nuk e ushtrojnë autoritetin e tij për të lëshuar udhëzime.*

3. *Distributori duhet të sigurojë licencat e nevojshme për Produktet e Kontratës në territor. Kostot e licencave të tilla do të mbulohen nga Shitesi dhe Distributori në mënyrë të barabartë.*

4. *Distributori duhet të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të promovuar vazhdimisht shitjen e Produkteve të Kontratës në territor. Për këtë qëllim, ai duhet të angazhojë një numër të mjaftueshëm shitësish të trajnuar dhe të mirëmbajë ambiente të përshtatshme biznesi (duke përfshirë sallat e ekspozitës dhe punetori).*

5. *Distributori është përgjegjës për të siguruar trajnimin e nevojshëm të punonjësve të tij në lidhje me Produktet e Kontratës.*

- Autorizim _Pro_Tire_per_Gajd, Autorizim distributor për “Gajd Company” SHPK, ku thuhet shprehimisht si vijon:

“Shoqëria Pro-Tire shpk (L71312509H), me adrese në Vore, Muçaj, Rruga Industriale, Zona Kadastrale 2726, Nr.Pasurie 89/71, vol.61, Faqe 51, kompani lider në tregtimin e Pjesëve të Këmbimit, Baterive, Gomave dhe Lubrifikatëve.

Me anë të këtij dokumenti autorizojmë shoqërinë: GAJD Company shpk, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Bizneseve), me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K79631501Q, me adresë TIRANË, Selite e vogël; të ofrojë, të negociojë dhe të lidhë kontrata me Autoritetin Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, për procedurën e prokurimit me objekt: Loti 1: “Blerje goma”, me nr. REF- 77570-02-26-2026.

GAJD Company sh.p.k autorizohet të tregëtojë mallrat Goma, për të cilat shoqëria jonë është e autorizuar si distributor ekskluziv për brandet/markat e gomave Nexen, Kumho, Doublestar, Comforser, Gripmax, Speedëays, Xingyan, Long March, Mirage, Agate, Aufine, Rotalla, Routeëay, Three-A, Everton dhe SEHA.

Me anë të kësaj garantojmë se japim mbështetjen tonë të plotë përsa i përket përdorimit, tregtimit, shitjes së mallrave Goma të brandeve/markave të mesiperme për të cilat Pro-Tire sh.p.k është distributor ekskluziv në territorin e Republikës së Shqipërisë, gjithashtu garantojmë cilesinë, garancinë dhe mbështetjen teknike.

Ky autorizim do të jetë i vlefshëm edhe në rast të shtyrjes së datës së tenderit. ”

III.1.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.1.11. Për sa më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në ofertën teknike, ankimesi ka deklaruar llojin e mjetit, llojin e gomës, markat, kataloget dhe faqet e katalogut, kodin e gomës, vendimin e origjinës, Eëbsite link si dhe certifikimet. Në ofertë janë paraqitur fletë nga katalogët e gomave. Gjithashtu është paraqitur një kontratë shitje ndërmjet shitësit PB Tire

SRP, DUNAJSKA 66, 811 08 BRATISLAVA Sllovaki dhe blerësit Pro-Tire SHPK, MAMINAS, DURRËS, TIRANË, SHQIPËRI, sipas të cilës shitësi i jep blerësit të drejtën ekskluzive të distributorit në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë marrëveshje. Së fundmi është paraqitur dokumenti “Autorizim Distributori” me anë të së cilës kompania distributore autorizon shoqërinë “Gajd Company” SHPK të ofrojë, të negociojë dhe të lidhë kontrata me Autoritetin Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve dhe Ndriçimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit për brandet/markat e gomave objekt ankimi.

Lidhur me faktin e konstatuar nga KSHA se: *“në rastin kur dokumentacioni i paraqitur nuk arrin të provojë në mënyrë të qartë dhe të pakundërshtueshme përmbushjen e një kriteri kualifikues, autoriteti kontraktor nuk ka detyrimin të kërkojë sqarime, [...] ekzistenca e një kontrate ndërmjet PB Tire SRO dhe Pro-Tire SHPK nuk mjafton për të provuar automatikisht se operatori ekonomik « Gajd Company » SHPK gëzon statusin e distributorit të autorizuar për markat objekt prokurimi, nëse nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezulton qartë e drejta e transferimit të autorizimit apo marrëdhënia juridike që legjitimon një autorizim të tillë», Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor nuk është i qartë për dokumentacionin e paraqitur nga ankimesi, edhe në kushtet kur ky i fundit ka dhënë indicie për autoritetin kontraktor, për verifikime të thelluara. Në këto kushte, referuar nenin 92 të LPP autoriteti kontraktor ka patur detyrimin procedural të kryejë verifikimet përkatëse apo të kërkojë sqarime nga ankimesi, gjë për të cilin rezulton se AK nuk ka kërkuar sqarime duke e marrë të mirëqenë që shoqëria “Gajd Company” SHPK, nuk plotëson kapacitetin teknik të parashikuar në opikën 2.3.2 të kriterëve të vecanta të kualifikimit lidhur me autorizimin e prodhuesit apo distributorit të autorizuar nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi. Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me *lex specialis*. Gjithashtu përfituesi i drejtpërdrejtë i objektit të prokurimit është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 124 të LPP-së ku përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi. 2. Për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor. 3. Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. 4. Çdo modifikim i kontratës në përputhje me nenin 127 të këtij ligji, pasqyrohet në planin e zbatimit. 5. Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit. 6. Rregulla të*

hollësishme për monitorimin e zbatimit të kontratave, sipas tipologjive të tyre, përcaktohen nga rregullat e prokurimit publik. Autoriteti kontraktor duhet të kryejë pagesat në favor të operatorëve ekonomikë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi.”

Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e furnizimit të kërkuar është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues përse i perket shoqërive të tjera pjesëmarrëse në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë K.P.P, operatori ekonomik ankimues nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori*, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me plotësimin e kriterëve kualifikuese nga ofertuesit e tjerë.

Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3:

Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.

Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se ankimuesi duhej të kishte shoqëruar pretendimet e tij me prova, indicie dhe argumente, në bazë të të cilave do të shqyrtohen këto pretendime. Vlen të ritheksojmë se, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë, se në cilin fakt apo rrethanë i mbështet pretendimet e tij për kualifikimin e padrejtë të shoqërive të tjera. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjitha apo shumicën e elementeve përbërëse të dokumenteve të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si i tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i

Prokurimit Publik, refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument.

Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Gajd Company” SHPK lidhur me procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-77570-02-26-2026, me objekt: “Loti I: Blerje goma”, me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugeve dhe Ndriçimit Publik Tirane.
2. Autoriteti kontraktor të bëjë rivlerësim të ofertës së operatorit ekonomik “Gajd Company” SHPK në zbatim të konstatimeve të KPP-së në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Gajd Company” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

